



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Shkurt 2022

Nr: 79

V E N D I M

Sot më datë 16.2.2022, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike, rishqyrtova çështjen me:

Kërkues: Subjekti Zgjedhor “Lëvizja e Re”

Ndaj: Vendimit nr. 72, datë 12.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Objekti i Ankimit: “Për rishqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.”

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, pika 2 dhe 3 neni 72, nenit 73, neni 165, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, neni 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, udhëzimi nr. 01, datë 23.12.2020, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” të ndryshuar si dhe vendimi nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve



Data: 16 Shkurt 2022
Nr. 79

“Për rishqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, të ndryshuar,

I. Rrethanat e faktit

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rogozhinë dhe Lushnjë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 35, datë 2.2.2022, “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë Lëvizja e Re për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, ka regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, Partia “Lëvizja e Re”, me kryetar z. Arian Galdini.

Në bazë të nenit 67, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistron kandidatët për kryetar në bashkinë Durrës, pasi bashkia Durrës nuk administrohet nga një KZAZ e vetme.

Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 2, datë 22.1.2022, Partia “Lëvizja e Re” ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e z. Jonid Robert Nano, si kandidat për kryetar në bashkinë Durrës dhe dokumentacionin shoqërues.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës si më poshtë listuar:

1. Kërkesë e partisë politike për regjistrimin e kandidat për kryetar, në bashkinë Durrës.
2. Kopje të dokumentit të identifikimit të kandidatit për kryetar bashkie z. Jonid Robert Nano.
3. Deklarimi i llogarisë bankare të posaçme të kandidatit, sipas Model 03/1 të Udhëzimit.
4. Deklarata e kandidatit ku deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 72, të Kodit Zgjedhor, sipas Model 05.
5. Vërtetim nr. 1043 prot., datë 2.2.2022, nënshkruar nga kryetari i këshillit bashkiak, Durrës.
6. Jetëshkrimi i kandidatit për kryetar bashkie, sipas Model 07 të Udhëzimit.
7. Formulari i vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, me nr. 9 unik, datë 8.2.2022.
8. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave, sipas Model 08 të Udhëzimit.



Z. Jonid Robert Nano, në përputhje me parashikimet e nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kryetarit të bashkisë.

Nga verifikimi prima facie i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, qarku Durrës, z. Jonid Robert Nano, rezulton se: Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e tij dhe është shprehur se ka ndryshuar emrin nga “Jani/Janiol” në “Jonid”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 616 prot., datë 8.2.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 615 prot., datë 8.2.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për kryetar në bashkinë Durrës, Qarku Durrës, z. Jonid Robert Nano.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1491/1 prot., datë 10.2.2022, deklaron se kandidati për kryetar z. Jonid Robert Nano, rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë, pra është i padënuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi verifikoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re” dhe konstatoi se dokumentacioni i depozituar përmban të gjithë elementët dokumentarë, por ka pasaktësi në përmbajtjen e tyre, pasi subjekti zgjedhor nuk disponon mandat në këshillin e bashkisë, Durrës. Vetëdeklarimi i zj. Alneida Nexhmi Rroshi, anëtare e këshillit të bashkisë Durrës, se mbështet kandidatin e subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”, nuk përmbush kushtin ligjor sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.

Nëpërmjet shkresës nr. 788 prot., datë 11.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ju drejtua këshillit të bashkisë Durrës, për t’i vënë në dispozicion vërtetimin për përkatësinë e partisë politike të anëtarit të këshillit të bashkisë Durrës, zj. Alneida Nexhmi Rroshi.

Këshilli i Bashkisë Durrës, nëpërmjet shkresës nr. 1372/1 prot., datë 11.2.2022, protokolluar me tonën nr. 788/1 prot., datë 12.2.2022, vërteton se zj. Alneida Nexhmi Rroshi, është anëtare në këshillin bashkiak Durrës, dhe i përket subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 72, datë 12.02.2022 “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, ka vendosur mosregjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

Subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sankisoneve, kundër vendimit nr. 72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke e konsideruar këtë vendim, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor, si dhe afatet e përcaktuara nga vendimi i Komisionit Rregullator nr. 2, datë 22.01.2022.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sankisoneve, me vendimin nr. 8, datë 15.2.2022 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 03, paraqitur në KQZ në datën 12.02.2022”, vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 03, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, shfuqizimin e vendimit nr. 72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim.

Subjektit “Lëvizja e Re” ju la afat që brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e vendimit të KAS, të bëjë plotësimin e vërtetimit për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 68, të Kodit ose depozitimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhëve, sipas pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.

II. Rishqyrtimi i çështjes

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në respektim të vendimit nr. 8, datë 15.2.2022, të KAS, ditën e mërkurë, më datë 17.09.2021, ora 16:00, në përputhje me përcaktimet e nenit 47 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rishqyrtoi çështjen, duke zhvilluar një seancë publike, në të cilën u thirr për të qënë prezent në mbledhje përfaqësuesi i subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”.
- Në seancën e rishqyrtimit të çështjes i pranishëm ishte kryetari i subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” z. Arian Galdini.
- Kryetari i subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”, kërkoi regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano.

III. Analiza e fakteve dhe provave



Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se:

- Në përfundim të afatit për depozitimin e dokumentacionit të kërkuar, konstaton se subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, nuk depozitoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vërtetimin për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 68, të Kodit Zgjedhor ose listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.
- Bazuar në nenin 68, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vërtetimi për zotërimin e mandatit përfaqësues bën pjesë në listën e dokumentave të kandidimit për t’u depozituar nga kandidati për kryetar bashkie. Mungesa e vërtetimit mund të zëvendësohet me listën mbështetëse prej jo më pak se 1 përqind e numrit të zgjedhësve, në zonën zgjedhore ku kandidon kandidati për kryetar bashkie.
- Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor, vërtetimi për zotërimin e mandatit duhet të lëshohet nga Kuvendi i Republikës ose nga organi i vetëqeverisjes vendore, dhe duhet të konfirmojë faktin se mbështetur në vetëdeklarimin pranë institucionit nga ana e mbajtësit të mandatit, subjekti zgjedhor kërkues zotëron një mandat përfaqësues me vlefshmëri jo më pak se 6 (gjashtë) muaj deri në përfundim të mandatit të organit përkatës.

Për sa më sipër konstatohet se, mungesa e depozitimit të dokumentacionit të kërkuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në bashkisë Durrës, z. Jonid Rober Nano, nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 68, pika 3, të Kodit Zgjedhor.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 67, pika 2, nenin 68, pika 3, nenin 72, nenit 73, nenin 165, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 2, datë



22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, të ndryshuar

V E N D O S I:

1. Mosregjistrimin e kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI

